



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA  
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos më, \_\_\_\_ .08.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Shërbim për transportin e punonjësve të Shoqërisë (QPN Gorisht + V.B. Cakran-Mollaj)

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 60100000-9 - Shërbime të transportit rrugor

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 12,974,917 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

### **Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.

### **OSE**

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

2.3.2 Liçensa për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetëse, rrethqytetëse ose ndërqytetëse për transport rrugor të udhëtarëve të lëshuar nga organet kompetente

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 4, germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i licencuar në kryerjen e shërbimit të transportit të udhëtareve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi apo me qira të paktën 6 (gjashtë) mjete tip autobus sipas kërkesave në termat e referencës dhe specifikimet teknike,

**Pronesia** e mjeteve të vertetohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të paraqesë, lejen e qarkullimit të mjetit rrugor në emër të ofertuesit, sigurancën të vlefshme, sigurancën për udhëtarët të vlefshme, akt kollauidimi të vlefshme, taksat vjetore.

**Mjeti i marrë me qira sipas pikës së mesipërme,** vertetohet me kontratën e qiramarrjes ose të huapërdorjes të lidhura para noterit, me afat vlefshmerie që përfshin edhe afatin e zbatimit të kësaj kontrate për këtë objekt prokurimi dhe e shoqëruar me dokumentacionin, lejen e qarkullimit të mjetit rrugor, sigurancën të vlefshme, sigurancën për udhëtarët të vlefshme, akt kollauidimi të vlefshme, taksat vjetore.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4 gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar kapacitetin teknik lidhur me mjetet në dispozicion të ofertuesit për të realizuar me sukses kontratën pasi sipas termave të kontratës ofertuesit duhet të ofrojë shërbimin e transportit me të paktën 6 (gjashtë) mjete autobuze.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Njesia e prokurimit:**